



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "L'ART COM AG" Sh.P.K. të datës të datës 16.01.2016 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i këndeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunën e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "L'ART COM AG" Sh.P.K. të datës të datës 16.01.2016 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i këndeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunën e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "L'ART COM AG" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i këndeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunën e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-26-14-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** “Duke marrë parasysh se objekti i këtij tenderi dhe punët e parapara në paramasë kanë të bëjnë me furnizim me lojëra dhe jo me procese prodhuese apo menaxhim energjetik, konsiderojmë se kërkesa për këtë standard nuk është relevante dhe nuk ka lidhje direkte me natyrën e kontratës dhe si e tillë mund të krijojë kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë. Për këtë arsye kërkojmë që kriteri për ISO 50001:2018 të hiqet nga dosja e tenderit pasi nuk ndikon në cilësinë apo funksionalitetin e furnizimit që kërkohet.

Në paramasë është kërkuar dorëzimi i mostrave para aplikimit, mirëpo dëshirojmë të theksojmë se mostrat e kërkuara nuk gjenden aktualisht në Kosovë dhe duhet të importohen nga jashtë vendit. I gjithë procesi për t’i sjellë këto mostrave kërkon kohë shtesë e cila nuk është e mjaftueshme brenda afatit aktual të tenderimit. Për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë kërkojmë që afati i tenderimit të shtyhet për një periudhë të arsyeshme në mënyrë që të kemi mundësi reale për sigurimin dhe dorëzimin korrekt të mostrave të kërkuara.

Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, konkretisht pikës 10, ku është paraparë që marrëveshjet për makineri të jenë të lidhura përmes kontratave të noterizuara duke u bazuar në dispozitat në fuqi të legjislacionit për prokurim publik në Republikën e Kosovës. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, kërkesa për noterizim të marrëveshjeve për makineri përbën një kërkesë shtesë që nuk është e domosdoshme sipas rregullores në fuqi, krijon barrë administrative dhe financiare të panevojshme për operatorët ekonomikë”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese.

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit,** duhet sqaruar se ky aktivitet i prokurimit ka rëndësi të konsiderueshme për autoritetin kontraktues. Rrjedhimisht realizimi i projektit duhet të bëhet në përputhje me standardet më të larta të cilësisë. Me qëllim që të garantohet ky standard i cilësisë, në përputhje me nenin 70 të LPP është parashtruar edhe kërkesa në fjalë për ISO 50001:2018. Vlen të përkujtohet se menaxhimi me sistemet e energjisë gjatë realizimit të projektit është absolutisht e domosdoshme për të prodhuar dhe instaluar këndet e lodrave dhe fushat sportive për të cilat bëhet fjalë. Prandaj kjo pikë e pretendimit është e pabazuar.

Kërkesa për dorëzimin e mostrave është absolutisht e domosdoshme për të siguruar që OE i rekomanduar do të ketë kapacitetin e nevojshëm për të furnizuar AK me produktet e kërkuara. Kjo kërkesë bazohet në nenin 69 par. 2 nënpar. 4 të LPP lidhur me nenin 37 të RRPP. Fakti që një mostër ka një peshë specifike apo një OE nuk mund ta sigurojë në Kosovë por duhet ta importojë, nuk përbën arsye të ligjshme që AK të mos kërkojë verifikimin e mostrave sipas dispozitave të lartcekura. Prandaj edhe kjo pikë e pretendimit është e pabazuar.

Kërkesa për noterizimin e marrëveshjeve nuk është aspak barrë administrative, por është garancion që tenderuesi me të vërtetë do të ketë në posedim të pakufizuar pajisjet që kërkohen me DT dhe që janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar këtë projekt në mënyrë efikase dhe efektive. Noterizimi i dokumenteve mund të bëhet në secilin qytet të Kosovës, zgjatë vetëm disa minuta për një dokument dhe ka një kosto minimale. Pra nuk qëndron argumenti i barrës administrative. Prandaj edhe ky pretendim është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 19.01.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.